



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1876 Prot.

Vlorë më, 11.9.2024

VENDIM

Nr. 36, datë 11.09.2024

PËR

PAGESËN E MBINGARKESËS MËSIMORE TË REALIZUAR PËR SATAFIN
AKADENIK, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024

Mbështetur në nenin 49 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, piks 1, gërma e, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", si dhe referuar propozimit të Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë ardhur me shkresat nr. 1590/31, prot, datë 20.08.2024, 1590/34, prot, datë, 27.08.2024, Vendimit Nr.34, datë 30.08.2024, të Senatit Akademik, prot, datë, 02.09.2024, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 11.09.2024,

VENDOSI

1. Të miratojë pagesën e mbingarkesës mësimore të stafit akademik me kohë të plotë për vitin akademik 2023-2024 deri në 200 orë në auditor.
2. Të miratojë pagesën e mbingarkesës mësimore për vitin akademik 2023-2024 nga 200-300 orë për orët suplementare në auditor , vetëm për rastet ku ekziston propozimi i Njesisë Bazë dhe miratimi i drejtuesit të Njesisë Kryesore, i cili e konsideron rastin si specifik.Orët e pa argumentuara të paguhen kur të plotësohet dokumentacioni përkatës.
3. Të miratojë pagesën e orëve të temave të diplomës të cilat kanë dokumentacion të plotë justifikues.Temat e diplomave të pa argumentuara do të paguhen kur të plotësohet dokumentacioni i plotë.
4. Të mos miratojë pagesën për orët suplementare që nuk janë të planifikuara në Buxhetin e vitit 2024.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Sotir NIKOLLA